



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 14 prot.

Kamëz, më 3. 2. 2022

V E N D I M

Nr. 12 Datë 3/2 2022

MBI

MIRATIMIN E SHEMBJES SË SHKOLLËS 9-VJEÇARE "DEMOKRACIA" ME  
ADRESË NË RRUGËN "ZHVILLIMI" SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I  
DATËS 26.11.2019.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 03.02.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt –Vendim Nr.12 Datë 03.02.2022 në mbështetje të neni 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1 shkronja b", nenit 29 pika 1, nenit 54 shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", nenit 57 nenit 58, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" ,ligji nr.9780 date 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" akti normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit nr.165, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e njëjësive zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore", Vendimit nr.26, datë 15.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 30.05.2013 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të qarkut Tiranë", Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 05.09.2013 "Për miratimin e listës perfundimare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të qarkut Tiranë" , referuar akt-ekspertizës dërguar nga Insituti i Ndërtimit me anë të shkresës nr.5752 prot. date 02.06.2021, **Këshilli Bashkiak Kamëz**";

V E N D O S I:

1. Miratimin e shembjes së shkollës 9-vjeçare "**Demokracia**" sipas akt-ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Policia Bashkiake mbështet Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.  
Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.
5. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
6. Këshilli Bashkiak Kamëz ngarkon për zbatimin e këtij vendimi, Drejtorinë e Rindërtimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore, Licensave dhe Kadastrës, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Kryetar Këshilli**  
**Hysen Koldashi**

